



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.105

6 tetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.59, datë 18.9.2006	Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike.....	4151
Dekret nr.5037 datë 27.9.2006	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	4152
Udhëzim i KQZ nr.3, datë 27.9.2006	Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të zgjedhjeve për qeverisjen vendore.....	4152
Udhëzim i KQZ nr.4, datë 28.9.2006	Për detyrat e Policisë së Shtetit dhe forcave të ushtrisë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.....	4161

VENDIM
Nr.59, datë 18.9.2006

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR VERIFIKIMIN E PASURIVE, LIDHJEVE NEPOTIKE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE TË ZYRTARËVE TË LARTË TË INSTITUCIONEVE KUSHTETUESE DHE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të neneve 3,5,6,8 dhe 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike, si dhe personave të lidhur me ta, për periudhën 1992-2006.

II. Komisioni Hetimor Parlamentar verifikon pasuritë, lidhjet nepotike dhe konfliktin e interesave të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, që gjatë periudhës së përcaktuar në pikën I, kanë ushtruar ose ushtrojnë detyrat e mëposhtme:

- i) President i Republikës;
- ii) Kryetar dhe zëvendëskryetar i Kuvendit;
- iii) Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministër dhe zëvendësministër;
- iv) Kryetar dhe zëvendëskryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- v) Kryetar partie politike parlamentare;
- vi) Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- vii) Anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- viii) Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjyqtar i Gjykatës së Lartë;
- ix) Drejtues institucioni të pavarur kushtetues dhe qendror publik.

III. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga shumica parlamentare dhe 5 nga opozita. Kryetar i Komisionit, në bazë të nenit 9 pika 3 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i takon grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

IV. Përbërja e Komisionit është si më poshtë:

- | | |
|------------------|-----------------|
| 1. Bujar Nishani | Kryetar |
| 2. | zëvendëskryetar |
| 3. Ramiz Çobaj | anëtar |
| 4. Mehmet Hoxha | “ |
| 5. Genc Sharku | “ |
| 6. Astrit Patozi | “ |
| 7. Dashnor Sula | “ |
| 8. | “ |
| 9. | “ |
| 10. | “ |
| 11. | “ |

V. Afati i veprimtarisë së Komisionit është 5 muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij Komisioni.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.5037, datë 27.9.2006

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9, pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, si dhe me propozim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Besart Selim Berisha
2. Mërgim Mustafë Mavraj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

UDHËZIM **Nr.3, datë 27.9.2006**

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZGJEDHJEVE PËR QEVERISJEN VENDORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 31 pika 1, germa b, nenit 40 e vijues të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit të KQZ-së nr. 52, datë 24.08.2006 “Për caktimin e Partive Politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZQV-ve”,

UDHËZON:

PJESA I **TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KZQV- së, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, caktimin e rregullave për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve, marrjen e vendimeve, si dhe marrëdhëniet e KZQV-së me të tretët.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Komisioni i Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore (KZQV) është organ kolegjal. Ai përgjigjet për zhvillimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore, brenda territorit të njësisë së qeverisjes vendore (Bashki/Komunë).

2. Të drejtat dhe detyrat e KZQV-së përcaktohen në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të KQZ-së, të cilat kanë fuqi detyruese për KZQV-në.

3. KZQV-ja ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme, profesionale dhe transparente.

PJESA II
PËRBËRJA E KZQV-SË

Neni 3
Ngritja e KZQV-së

1. KZQV-ja ngrihet me vendim të KQZ-së, në bazë të propozimeve të partive politike përkatëse.
2. Sekretari i KZQV-së emërohet nga KQZ-ja me propozim të partisë që ka propozuar zv/kryetarin.

Neni 4
Shkarkimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZQV-së

1. Anëtari dhe sekretari i KZQV-së shkarkohen nga detyra në këto raste:
 - a. Shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor ose të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me detyrat e KZQV-së;
 - b. Nuk plotësojnë kushtet për të qenë zgjedhës;
 - c. Nuk kanë më vendbanimin e tyre në njësinë zgjedhore;
 - d. Dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose janë të ndaluar për kryerjen e tij;
 - e. Mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZQV-së, ose në periudhën zgjedhore nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se dy ditë rresht;
 - f. Nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.
2. Propozimi për shkarkimin e anëtarit apo sekretarit të KZQV-së mund të bëhet nga KZQV-ja, si dhe nga çdo subjekt zgjedhor.
3. Shkarkimi bëhet me vendim të KQZ-së.

Neni 5

1. Anëtari dhe sekretari i KZQV-së i shkarkuar me vendim të KQZ-së, nuk mund të propozohen më në këtë detyrë.
2. a. Anëtari i KZQV-së, i shkarkuar me vendim të KQZ-së, ndërpret menjëherë punën dhe i dorëzon dokumentacionin sekretarit të KZQV-së.
 - b. Në rastet kur shkarkohet sekretari i KZQV-së, ai ia dorëzon dokumentacionin e punës kryetarit dhe zv/kryetarit të KZQV-së. Procesi i dorëzimit pasqyrohet në librin e protokollit.
 - c. Në rastet kur shkarkohet kryetari ose zv/kryetari, dokumentacioni dorëzohet te sekretari i KZQV-së, në prani të kryetarit ose sipas rastit zv/kryetarit dhe të anëtarëve të tjerë të komisionit. Procesi i dorëzimit pasqyrohet në librin e protokollit të KZQV-së.
 - d. Në rastet kur shkarkohet e gjithë KZQV-ja, ky dokumentacion depozitohet në KQZ.

Neni 6
Lirimi nga detyra i anëtarit apo sekretarit të KZQV-së

1. Anëtari ose sekretari i KZQV-së lirohet nga detyra kur:
 - a. Subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.
 - b. Kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në njësinë zgjedhore përkatëse.
 - c. Janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në njësinë zgjedhore.
2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 germa b dhe c të këtij neni, propozimi për lirimin nga detyra të anëtarit ose sekretarit të KZQV-së, mund të paraqitet nga çdo subjekt zgjedhor.
3. Procedura e dorëzimit të dokumentacionit, në rastet e liritimit nga detyra, është e njëjtë si në rastet e parashikuara në nenin 5 pika 2 të këtij udhëzimi.

Neni 7

Plotësimi i vendit vakant

1. Kur vendi i një anëtari të KZQV-së mbetet vakant, kjo e fundit njofton menjëherë KQZ-në.
2. Procedura për emërimin e anëtarit të ri, i cili plotëson vendin vakant, është e njëjtë me rastet e parashikuara për emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZQV-së.
3. Kur anëtari i KZQV-së jep dorëheqjen, deklarata e dorëheqjes depozitohet në KZQV. Sekretari bën shënimet përkatëse në librin e protokollit të KZQV-së, njofton KQZ-në dhe subjektin politik që e ka propozuar.
4. Në rastet kur dorëheqjen e jep sekretari, këtë procedurë e kryen kryetari ose zv/kryetari i KZQV-së.

Neni 8

Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe të sekretarit të KZQV-së

Anëtari dhe sekretari i KZQV-së nuk mund të jenë:

1. deputetë në Kuvend;
2. kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
3. ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
4. anëtarë ose sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

PJESA III

EMËRIMI I KRYETARIT OHE ZËVENDËSKRYETARIT TË KZQV

Neni 9

Propozimi i Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KZQV-së

1. KZQV-ja merr vendim për propozimin e kryetarit dhe zv/kryetarit të KZQV-së.
2. Në KZQV-të, ku anëtari i shtatë emërohet me propozim të Partisë Demokratike të Shqipërisë, njëri prej dy anëtarëve të emëruar me propozim të PDSH-së, i propozohet KQZ-së për t'u emëruar kryetar i KZQV-së. Në këto raste vetëm anëtari i emëruar me propozim të PSSH, i propozohet KQZ-së për t'u Emëruar zv/kryetar i KZQV-së.
3. Në KZQV-të, ku anëtari i shtatë emërohet me propozim të Partisë Socialiste, njëri prej dy anëtarëve të emëruar me propozim të PSSH-së, i propozohet KQZ-së për t'u emëruar kryetar i KZQV-së. Në këto raste vetëm anëtari i emëruar me propozim të PDSH-së, i propozohet KQZ-së për t'u emëruar zv/kryetar i KZQV-së.
4. Për propozimin e kryetarit, çdo anëtar i KZQV-së duhet të votojë njërin prej dy anëtarëve të propozuar, sipas rastit të PDSH apo të PSSH.
5. Anëtarët e KZQV-së votojnë pro emërimit të zv/kryetarit të KZQV-së, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni.
6. Vendimet e KZQV-së i dërgohen menjëherë KQZ-së.

PJESA IV

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARIT TË KZQV-SË

Neni 10

Të drejtat e anëtarit të KZQV-së

1. Anëtari i KZQV-së ka të drejtën e shpërblimit për punën e bërë. Masa e shpërblimit caktohet me vendim të KQZ-së.
2. Gjatë kohës që anëtari i KZQV-së ushtron këtë detyrë, nuk humbet të drejtat dhe detyrat në vendin e tij të punës.
3. Në rastet kur anëtari i KZQV-së ndalohet ose arrestohet gjatë periudhës zgjedhore, organi

kompetent i cili kryen veprimin, si dhe vetë KZQV-ja, njofton menjëherë KQZ-në.

4. Çdo anëtar i KZQV-së ka të drejtë të komunikojë dhe informojë KQZ-në për çdo problem që ai e sheh të arsyeshëm sipas mënyrës së përcaktuar në këtë udhëzim.

Neni 11

Detyrat e anëtarit të KZQV-së

1. Anëtar i KZQV-së është i detyruar të zbatojë Kushtetutën, Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së, si dhe të respektojë vendimmarrjen në KZQV.

2. Anëtar i KZQV-së është i detyruar të paraqitet rregullisht në detyrë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim dhe akte të tjera të KQZ-së.

3. Në ushtrimin e funksionit të tij anëtar i KZQV-së duhet të respektojë rregullat e etikës.

4. Anëtar i KZQV-së është i detyruar që gjatë procesit të vendimmarrjes të shprehë mendimin e tij me anë të votimit. Në asnjë rast anëtar i KZQV-së nuk mund të abstenojë.

PJESA V

Neni 12

Të drejtat dhe detyrat e sekretarit të KZQV-së

1. Sekretari KZQV-së ka këto të drejta:

a. merr pjesë në mbledhjet e KZQV-së;

b. diskuton dhe jep mendimin e tij në mbledhjet e KZQV-së, për çështje që shqyrtohen, sa herë shihet e arsyeshme nga komisioni;

c. të drejta të tjera që burojnë nga Kodi Zgjedhor.

2. Sekretari i KZQV-së kryen këto detyra:

a. administron dhe ruan të gjithë dokumentacionin e KZQV-së, si dhe është përgjegjës për përdorimin e vulës;

b. protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZQV-së;

c. jep asistencë për KZQV-në, kur kjo i kërkohet nga kryetari ose zv/kryetari në emër të komisionit;

ç. përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit ose zv/kryetarit, materialet e mbledhjes dhe ua shpërndan ato anëtarëve të KZQV-së;

d. mban procesverbalet e mbledhjeve të KZQV-së. Në fillim të çdo mbledhjeje evidenton prezencën e anëtarëve të KZQV-së;

dh. regjistron vendimet e KZQV-së në librin e protokollit dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;

e. brenda 12 orëve nga miratimi i vendimit, sekretari përpilon aktin zyrtar në përputhje me modelet e miratuara nga KQZ-ja;

ë. u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZQV-së dhe kopje të procesverbaleve të mbledhjeve të tyre, kur është e mundshme;

f. regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KQZ-ja, sipas nenit 93 të Kodit Zgjedhor dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor;

g. me kërkesë të zgjedhësve, lëshon vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve në njësinë zgjedhore përkatëse;

gj. kryen detyra të tjera që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së;

h. regjistron në librin e protokollit vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin komisionit.

i. në bashkëpunim me kryetarin dhe zv/kryetarin e KZQV-së administron procesin e shpërndarjes së bazës materiale zgjedhore nga KZQV-ja në KQV dhe anasjelltas.

PJESA VI

PËRFAQËSUESIT E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Neni 13

Përfaqësuesi i kandidatit

1. Çdo kandidat për kryetar në njësinë e qeverisjes vendore, së bashku me dokumentet e kandidimit, i paraqet KZQV-së edhe emrin e personit, i cili do të jetë përfaqësuesi i tij zyrtar në KZQV.

2. Sekretari i KZQV-së, pajis përfaqësuesin e kandidatit me dokument identifikimi, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja, si dhe e njeh me të drejtat dhe detyrat e tij.

Neni 14

Të drejtat e përfaqësuesit të kandidatit

Përfaqësuesi i kandidatit ka të drejtë:

1. Të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e KZQV-së;
2. Të paraqesë propozime e kërkesa për çështje, të cilat shqyrtohen në rendin e ditës;
3. Në përfundim të mbledhjes së KZQV-së, ka të drejtë të paraqesë propozime për çështje të ndryshme, që nuk kanë qenë në rendin e ditës;
4. Të marrë kopje të vendimeve si dhe të tabelave të rezultateve;
5. Të kërkojë informacion për të gjitha aspektet e veprimtarisë së KZQV-së dhe t'i vëzhgojë ato, pa penguar zhvillimin normal të veprimtarisë së saj;
6. Të ndjekë programet trajnuese të KZQV-së.

Neni 15

Detyrat e përfaqësuesit të kandidatit

Përfaqësuesi i kandidatit ka për detyrë:

1. Të respektojë dispozitat e Kodit Zgjedhor, të këtij udhëzimi, si dhe akteve të tjera që lidhen me organizimin dhe funksionimin e KZQV-së;
2. Të zbatojë rregullat e etikës në KZQV;
3. Të mbajë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit, të lëshuar nga KZQV-ja;
4. Të mos mbajë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit.
5. Në ambientet e KZQV-së të mos bëjë propagandë ose veprime që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në punën e KZQV-së.

Neni 16

Në rast se përfaqësuesi i kandidatit nuk respekton dispozitat e parashikuara në nenin 15 të këtij udhëzimi, KZQV-ja njofton kandidatin dhe i kërkon atij zëvendësimin me një përfaqësues tjetër.

Neni 17

Vëzhguesit

KZQV-ja merr vendim për caktimin e vëzhguesve, sipas rregullave të përcaktuara në një akt të veçantë të KQZ-së.

PJESA VII

DETYRAT DHE FUNKSIONIMI I KZQV

Neni 18

Detyrat e KZQV-së

KZQV-ja kryen këto detyra:

1. Përgjigjet për administrimin e zgjedhjeve në njësinë e qeverisjes vendore, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe këtij udhëzimi
2. Emëron kryetarin, zv/kryetarin, anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve dhe GNV-ve;

3. Verifikon dokumentacionin e kandidatëve dhe merr vendim për regjistrimin e tyre;
4. Mban kontakte të vazhdueshme me KQZ-në dhe me organet e qeverisjes vendore;
5. Njofton anëtarët e KQV-ve dhe GNV-ve për programet e trajnimit të organizuara nga KQZ-ja, merr masa për mbarrëvajtjen e tyre, si dhe evidenton pjesëmarrjen;
6. Garanton në kohë shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore nga KZQV-ja në KQV dhe anasjelltas;
7. Bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore, për sigurimin e ambienteve dhe bazës së nevojshme logjistike, për funksionimin e KZQV-së, KQV-ve dhe GNV-ve;
8. Dërgon informacion të vazhdueshëm në KQZ mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e saj;
9. Afishon në vende publike të dhëna që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në njësinë zgjedhore përkatëse;
10. Shqyrton dhe merr vendim për të gjitha kërkesat dhe ankesat e paraqitura nga subjektet zgjedhore;
11. Mbikëqyr dhe asiston në përgatitjen e mjediseve të qendrave të votimit, merr masa për përshtatjen e mjediseve të QV-ve për të lehtësuar votimin e personave me aftësi të kufizuara;
12. Verifikon dhe mbikëqyr masat që janë marrë për sigurimin dhe ruajtjen e materialeve zgjedhore deri në fillimin e procesit të votimit;
13. Bashkëpunon me strukturat e Policisë së Shtetit në lidhje me problematikën gjatë procesit zgjedhor;
14. KZQV-ja merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin e personave të tjerë në vendin e numërimit të votave, përveç atyre të parashikuar në pikën 1 të nenit 109/8 të Kodit Zgjedhor. Në rast të pranisë së personave të tjerë, KZQV-ja merr vendim dhe njofton menjëherë punonjësit e Policisë së Shtetit. Rasti mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KZQV-së, duke përfshirë orën e saktë të ardhjes dhe të largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit;
15. Përgatit tabelën e rezultateve të zgjedhjeve në njësinë e qeverisjes vendore dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 109/7 të Kodit Zgjedhor;
16. Shpall rezultatet e zgjedhjeve në njësinë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të nenit 109/7 të Kodit Zgjedhor, lidhur me kandidatin fitues për kryetar të bashkisë ose të komunës dhe anëtarët e këshillit të bashkisë ose komunës.

Neni 19

Zyra e KZQV-së

1. Vendndodhja e zyrës së KZQV-së duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e nenit 95 të Kodit Zgjedhor. Ajo duhet të jetë me sipërfaqe të mjaftueshme për të siguruar zhvillimin normal të veprimtarisë së Komisionit.
2. Kryetari, ose i ngarkuari, i njësisë së qeverisjes vendore, në të cilën do të ketë zyrën KZQV-ja, duhet të sigurojë në kohë ambientin dhe pajisjet përkatëse.
3. Në zyrën e KZQV-së, në një vend të dukshëm duhet të vendoset flamuri kombëtar.
4. Në hyrjen kryesore për në zyrën e KZQV-së, duhet të vendoset tabela treguese e KZQV-së, si dhe të jenë afishuar emrat e anëtarëve të KZQV-së, numri i telefonit të zyrës dhe orari punës.
5. Zyra e KZQV-së duhet të pajiset me linjë telefonike të rrjetit fiks ose mjete të tjera të komunikimit.
6. Për aq sa është e mundur vendndodhja e zyrës duhet të jetë e përshtatshme dhe për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 20

Dokumenti i identifikimit

1. Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët dhe sekretari i KZQV-së janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit të miratuar nga KQZ.
2. Përfaqësuesit e kandidatëve të partive politike dhe vëzhguesit janë të detyruar që gjatë qëndrimit në mjediset e KZQV-së, të mbajnë dokumentin përkatës të identifikimit. Me mbarimin e detyrës ky dokument humbet vlefshmërinë e tij.

Neni 21

Vula e KZQV-së dhe përdorimi

1. KZQV-ja përdor vulën e miratuar me vendim nga KQZ-ja.
2. Vula e KZQV-së mbahet nga sekretari, i cili e administron atë në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet e tjera të KQZ-së.
3. Të gjitha aktet e nxjerra dhe të miratuara nga KZQV-ja, vulosen me vulën e KZQV-së.
4. Në mungesë të sekretarit gjatë vendimmarrjes së KZQV-së, vula përdoret nga zv/kryetari KZQV-së.
5. Vula nuk mund të nxirret jashtë ambienteve të punës së KZQV-së.
6. Në rast se vula e KZQV-së bëhet e papërdorshme, KZQV-ja mban një procesverbal në të cilin pasqyron rrethanat e pamundësisë së përdorimit të vulës dhe njofton menjëherë KQZ-në. Vula e vjetër dorëzohet në KQZ.
7. Në rast se vula e KZQV-së humbet, KZQV-ja mban procesverbal në të cilin pasqyron faktin, si dhe lajmëron organet e policisë. KZQV-ja, i dërgon KQZ-së kopje të procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit për organet e policisë. Në procesverbal duhet të përshkruhet qartë momenti i konstatimit të këtij fakti.

Neni 22

Koha e punës së KZQV-së

1. Në periudhën jozgjedhore KZQV-ja qëndron në detyrë nga ora 11.00 deri në ora 13.00 dhe nga ora 17.00 deri në orën 20.00.
2. Gjatë periudhës zgjedhore dhe deri tri ditë para datës së zgjedhjeve, KZQV-ja punon paradite nga ora 08.00-13.00 dhe mbasdite 16.00 - 20.00.
3. Tri ditë para datës së zgjedhjeve, ditën e zgjedhjeve dhe deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar dhe dorëzimin në KQZ të dokumentacionit zgjedhor përkatës, KZQV-ja është e detyruar të qëndrojë në mënyrë permanente e mbledhur në zyrë.
4. Orari i punës duhet të jetë i afishuar në një vend të dukshëm pranë mjediseve të KZQV-së.
5. Sekretari i KZQV-së shënon në procesverbal kohën e largimit dhe kthimit të çdo anëtari në komision.

PJESA VIII MBLEDHJET E KZQV

Neni 23

Njoftimi për mbledhjet e KZQV-së

1. Mbledhja e parë e KZQV-së thirret me vendim të KQZ-së.
2. Vendimi për mbledhjen e KZQV-së bëhet publik.
3. Vendimi u dërgohet partive politike, të cilat kanë propozuar anëtarët e KZQV-së dhe përmban: datën, vendin dhe orën e mbledhjes së parë të KZQV-së.
4. Në përputhje me vendimin e KQZ-së, sekretari i KZQV-së merr masa për njoftimin e anëtarëve dhe përgatitjen e mbledhjes.

Neni 24

1. Mbledhja e parë e KZQV-së drejtohet nga anëtari më i vjetër.
2. Në këtë mbledhje KZQV-ja merr vendim për propozimin e kryetarit dhe zv/kryetarit të KZQV-së, sipas modeleve të miratuara nga KQZ-ja.

Neni 25

Procedura e zhvillimit të mbledhjeve të KZQV-së

1. Mbledhjet e KZQV-së janë të hapura dhe publike. Ato zhvillohen vetëm në ambientet e saj të punës.
2. Kryetari, në mungesë të tij zv/kryetari, drejton mbledhjen e KZQV-së.
3. Mbledhjet e KZQV-së janë të vlefshme kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të saj.
4. Në vijimësi, mbledhjet e KZQV-së thirren nga kryetari, zv/kryetari ose së paku nga dy anëtarë të saj. Sekretari është përgjegjës për njoftimin e anëtarëve.
5. Sekretari është përgjegjës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve.

Neni 26

1. Drejtuesi i mbledhjes paraqet çështjen që është për shqyrtim dhe u jep fjalën anëtarëve për të diskutuar.
2. Çdo anëtar i KZQV-së diskuton dhe paraqet propozime për çështje që janë në rendin e ditës.
3. Në mbledhje u jepet fjala për të bërë pyetje apo diskutime edhe përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore.
4. Pasqyrimi i mbledhjeve të KZQV-së bëhet në librin e protokollit të mbledhjeve, i cili duhet të përmbajë:
 - Datën, vendin dhe orën e mbledhjes;
 - Anëtarët që morën pjesë;
 - Çështjet që u diskutuan;
 - Përmbajtjen e diskutimeve;
 - Rezultatit e votimit të anëtarëve të KZQV-së;
 - Vendimet që u morën.
5. Në mbledhjen e KZQV-së pjesëmarrësve u ndalohej çdo lloj komunikimi me telefon ose forma të tjera me të tretët.
6. Në përfundim të mbledhjes procesverbali përkatës në librin e protokollit të mbledhjeve, firmoset në çdo faqe nga sekretari. Anëtarët e KZQV-së, nëse dëshirojnë, kanë të drejtë të nënshkruajnë procesverbalin si më sipër.
7. Sekretari ka përgjegjësi të veçantë për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve. Gjatë mbajtjes së tij ai duhet të marrë në mënyrë të plotë emrat e personave të pranishëm në mbledhje. Merr masa që në procesverbalin e mbledhjeve të mos përdoren korrigjime apo lënie të hapësirave bosh. Sekretari duhet të riprodhojë me përpikmëri thëniet e pjesëmarrësve në mbledhje.

PJESA IX VENDIMMARRJA

Neni 27

Mbyllja e diskutimeve dhe votimi i propozimeve

Në përfundim të diskutimeve, drejtuesi i mbledhjes paraqet me radhë propozimet dhe fton anëtarët e KZQV-së për të votuar për secilin propozim.

Neni 28

Procedura e votimit dhe firmosja e vendimeve

1. Vendimet në KZQV merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZQV-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.
2. Vendimet e KZQV-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim, si dhe vulosen me vulën e KZQV-së nga sekretari.
3. Secili prej anëtarëve të KZQV-së krahas nënshkrimit të tij në vendim, shënon votën “pro” ose “kundër”.
4. Vendimet e KZQV-së shoqërohen me mendimin e pakicës, nëse ka të tillë.

5. Sekretari i KZQV-së shënon në librin e protokollit të mbledhjeve rezultatet e votimit për çdo propozim.

6. KZQV-ja është e detyruar që të bëjë menjëherë publike vendimet e marra dhe të dërgojë në KQZ një kopje të këtyre vendimeve.

7. Anëtarët e KZQV-së që janë të pranishëm në mbledhje, dhe që nuk kanë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë. Vota e anëtarëve që janë në konflikt interesi të parashikuar në nenin 41 pika 2 e Kodit Zgjedhor dhe nuk janë të liruar apo të emëruar nga KQZ-ja, është e pavlefshme dhe nuk llogaritet në kuorum.

8. Në rast se KZQV-ja nuk arrin të marrë vendim, atëherë brenda 24 orëve çështja i dërgohet për shqyrtim KQZ-së nga kryetari, zv/kryetari i KZQV-së apo nga të paktën dy anëtarë, ose mund të ankimohet nga subjekti zgjedhor i interesuar në KQZ. Vendimi i KQZ-së është i detyrueshëm për zbatim nga ana e KZQV-së.

PJESA X DOKUMENTACIONI I KZQV-së

Neni 29

1. Sekretari i KZQV-së është përgjegjës për mbajtjen në arkiv dhe sistemimin e dokumentacionit zgjedhor të KZQV-së. Sekretari i KZQV-së krijon dosje të veçanta për vendimet dhe udhëzimet e dërguara nga KQZ-ja, për aktet e nxjerra prej saj, për kërkesat, ankesat apo pretendimet e subjekteve zgjedhore, për emërimin e anëtarëve të KQV-ve dhe caktimin e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave.

2. Regjistri i korrespondencës së KZQV-së, sipas modelit tip të përgatitur nga KQZ-ja, mbahet nga sekretari i KZQV-së dhe shërben për regjistrimin e akteve të ndryshme që hyjnë dhe dalin nga KZQV-ja.

3. Regjistri i vendimeve të KZQV-së, sipas modelit tip të përgatitur nga KQZ-ja, mbahet nga sekretari i KZQV-së dhe shërben për regjistrimin e të gjitha vendimeve që merren nga KZQV-ja.

Neni 30

Përgjegjësitë dhe sanksionet

Anëtarët e komisioneve zgjedhore mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit në fuqi, për shkeljen e dispozitave të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

UDHËZIM Nr.4, datë 28.9.2006

PËR DETYRAT E POLICISË SË SHTETIT DHE FORCAVE TË USHTRISË NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 153 të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, nenit 29 pika 1 dhe nenit 104, 105, pika 2, nenit 116, nenit 109/1, pika 2 dhe 3, neni 109/8, pika 2, të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 60/a deri 60/ç të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë detyrat e Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë gjatë periudhës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të këtij udhëzimi me termin “Objekte zgjedhore” në çdo rast do të kuptohet godina ku është vendosur qendra e votimit, komisioni i zgjedhjeve për qeverisjen vendore dhe vendi i numërimit të votave.

Neni 3
Parime të përgjithshme

1. Rendi dhe siguria gjatë periudhës zgjedhore ruhet nga forcat e Policisë së Rendit dhe të Policisë së Objekteve.

2. Ndalohet përdorimi i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë dhe atyre Speciale, Policisë Kriminale dhe asaj Kufitare në ngjarje, që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

3. Ndalohet përdorimi i Forcave të Policisë së Shtetit dhe atyre të ushtrisë në veprime që mund të cenojnë vullnetin e shtetasve.

4. Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe forcave të tjera të ushtrisë gjatë periudhës zgjedhore, përveçse me urdhër me shkrim të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Mbrojtjes, kur këto forca nevojiten për ruajtjen e objekteve të rëndësisë së veçantë ose në zëvendësim të punonjësve të Policisë së Objekteve. Kopje e urdhrit me shkrim i dërgohet menjëherë KQZ-së.

5. Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet.

6. Ndalohet gjatë gjithë periudhës zgjedhore, kryerja e ushtrimeve ose manovrave ushtarake jashtë reparteve ose vendeve të dislokimit nga forcat e ushtrisë.

7. Ndalohet përdorimi apo pjesëmarrja e punonjësve ose strukturave të Shërbimit Informativ Shtetëror në ngjarjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet apo në veprime, që mund të ndikojnë në vullnetin e zgjedhësve.

Neni 4
Komunikimi ndërmjet KQZ-së, forcave të policisë dhe ushtrisë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës zgjedhore, dorëzon menjëherë në KQZ kopje të urdhrave për angazhimin e forcave të Policisë së Shtetit.

2. Në rast se KQZ-ja vlerëson se veprimtaria e forcave të Policisë së Shtetit ose të ushtrisë mund të dëmtojë apo të pengojë administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente, ajo ka të drejtë të kërkojë informacione. Institucioni përkatës është i detyruar të paraqesë menjëherë informacion për veprimet e kryera dhe marrjen e masave për zbatimin e ligjit.

3. KQZ-ja i dërgon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit listën e plotë të objekteve zgjedhore dhe adresat e sakta të vendndodhjes së tyre.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është i detyruar t’i paraqesë KQZ-së 30 ditë para datës së zgjedhjeve listën e plotë të punonjësve të ngarkuar me detyra gjatë zgjedhjeve. Ai është i detyruar të informojë menjëherë KQZ-në për çdo ndryshim në listë.

5. Për secilin nga punonjësit e përfshirë në listë, duhet të përcaktohen me shkrim, të dhënat personale, grada që mban, detyrat funksionale, vendvendosja e punonjësit gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe në ditën e votimit, emri i eprorit të drejtpërdrejtë të tij, lloji i shërbimit të policisë ku bën pjesë, si dhe, në mënyrë të detajuar, rrethi i detyrave të ngarkuara.

6. Për problemet që mund të lindin gjatë periudhës zgjedhore dhe që kanë të bëjnë me sjelljen dhe qëndrimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, KQZV-të i drejtohen Drejtorit të Policisë së Qarkut, ku ndodhet KQZV-ja, dhe njoftojnë menjëherë KQZ-në.

Neni 5
Ruajtja e objekteve zgjedhore

1. Selia e KZQV-së ruhet nga punonjësit e Policisë së Shtetit, nga momenti kur në të mbërrijnë materialet e votimit deri në datën e zgjedhjeve. Ruajtja do të bëhet prej orës 20.00 deri në orën 8.00 të ditës së nesërme.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, punonjësi i Policisë së Shtetit, nuk e kryen shërbimin e ruajtjes së selisë së KZQV-së gjatë kohës kur kjo e fundit është në punë.

3. Shërbimi i ruajtjes sipas pikës 1 të këtij neni fillon menjëherë me paraqitjen e kërkesës së kryetarit të KZQV-së. Kërkesa është me shkrim dhe i dërgohet për çdo rast, punonjësit të policisë dhe shefit të komisaritit që mbulon njësinë e qeverisjes vendore, ku është vendosur zyra e KZQV-së.

4. Kryetari i KZQV-së, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së zgjedhjeve, i dërgon një njoftim me shkrim shefit të komisaritit të njësisë së qeverisjes vendore, ku ndodhet zyra e KZQV-së. Njoftimi përmban vendndodhjen e KZQV-së dhe orarin e punës.

5. Policia organizon ruajtjen e qendrave të votimit gjatë natës para ditës së votimit duke filluar nga momenti kur në KQV mbërrijnë materialet zgjedhore deri në momentin kur KQV-ja fillon veprimet paraprake për çeljen e votimit.

6. Policia organizon ruajtjen e ambientit të vendit të numërimit të votave prej orës 18. 00 të ditës së zgjedhjeve deri në momentin e shpalljes së rezultatit nga KZQV-ja.

7. Punonjësi i Policisë së Shtetit qëndron jashtë ambienteve të vendit të numërimit të votave, sipas caktimit të bërë nga KZQV-ja.

Neni 6

Lejimi i punonjësit të Policisë së Shtetit për t'u futur në ambientet e VNV-së

1. Gjatë procesit të numërimit të votave, kur KZQV-ja konstaton se në ambientin e VNV-së janë të pranishëm dhe persona të tjerë, përveç atyre të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 109/8 të Kodit Zgjedhor, u kërkon atyre që të largohen. Në rast refuzimi, merr vendim për njoftimin e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe mban shënim në librin e protokollit.

2. Kur në vendin e numërimit të votave rrezikohet rendi, KZQV-ja me vendim thërret organet e Policisë së Shtetit.

3. Vendimi për kërkimin e ndihmës për vendosjen e rendit i paraqitet me shkrim organeve të Policisë së Shtetit dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe të rrethanave.

4. Me marrjen e vendimit, kryetari, zëvendëskryetari ose çdo anëtar i KZQV-së thërret menjëherë policinë dhe njofton KQZ-në për incidentin e ndodhur.

5. Sapo forcat e policisë paraqiten në vendin e numërimit të votave, vendimi për të ndërhyrë u dorëzohet atyre menjëherë.

6. Me rivendosjen e rendit në vendin e numërimit të votave, KZQV-ja me vendim u kërkon forcave të Policisë së Shtetit të largohen.

7. Vendimi i KZQV-së për ndërhyrje merret sipas modelit 34 V, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Neni 7

Lejimi i punonjësit të Policisë së Shtetit për t'u futur në ambientet e qendrës së votimit

1. Kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi ose zhvillimi i rregullt i votimit, KQV-ja me vendim thërret organet e Policisë së Shtetit.

2. Vendimi për kërkimin e ndihmës për vendosjen e rendit, i paraqitet me shkrim organeve të Policisë së Shtetit dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe rrethanave.

3. Me marrjen e vendimit, kryetari, zëvendëskryetari ose çdo anëtar i KQV-së thërret menjëherë policinë dhe njofton KZQV-në për incidentin e ndodhur.

4. Sapo forcat e policisë paraqiten në qendrën e votimit, vendimi për të ndërhyrë u dorëzohet atyre menjëherë.

5. Me rivendosjen e rendit në qendrën e votimit, KQV-ja, me vendim, u kërkon forcave të Policisë së Shtetit të largohen.

Neni 8

Veshja dhe armatimi i policisë

1. Punonjësit e forcave të Policisë së Shtetit, të ngarkuara me detyra zgjedhore sipas këtij udhëzimi, janë të detyruar të mbajnë uniformën gjatë ushtrimit të detyrës dhe dokumentin e identifikimit sipas modelit të përcaktuar në lidhjen 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2. Punonjësit e forcave të Policisë së Shtetit, të ngarkuar me detyra gjatë zgjedhjeve, mbajnë vetëm armatim personal brezi (pistoletë).

3. Punonjësit e forcave të policisë lejohen që, përveç armatimit personal të brezit, të mbajnë dhe automatik në rastet kur ngarkohen me ruajtjen e objekteve zgjedhore gjatë natës, me përjashtim të rastit kur janë ngarkuar të ruajnë godinën ku është caktuar vendi i numërimit të votave.

Neni 9

Lëvizjet e policisë

1. Qarkullimi i forcave të policisë, të ngarkuara me detyra zgjedhore, bëhet vetëm me mjete policie dhe vetëm në rast se kërkohet ndërhyrja e tyre respektivisht nga KQZ-ja, KZQV-ja ose nga KQV-ja.

2. Mjetet e përdorura prej policisë, në këto raste, duhet të kenë shenja dalluese që tregojnë se këto forca janë ngarkuar me detyra në funksion të zgjedhjeve.

Neni 10

Vendqëndrimi i policisë

1. Punonjësit e forcave të policisë që ngarkohen me detyra gjatë zgjedhjeve, me përjashtim të atyre që merren me ruajtjen objekteve zgjedhore, në 24 orët para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve, qëndrojnë brenda komisariateve ose në vende dislokimi larg qendrave të banuara.

2. Asnjë person i armatosur, duke përfshirë edhe forcat e policisë dhe ushtarakët, nuk lejohet të qëndrojë apo të hyjë në ambientet zgjedhore.

3. Përjashtohen nga përcaktimi i bërë në pikën 2 të këtij neni, rastet kur prania e forcave të policisë kërkohet përkatësisht nga KZQV-ja ose nga KQV-ja, si dhe në rastin e prezencës së punonjësve të Policisë së Burgjeve brenda territorit të burgut ose vendit të paraburgimit, ku është ngritur qendra e posaçme e votimit.

Neni 11

Shoqërimi i kutive të votimit dhe i materialeve zgjedhore

1. Me mbylljen e votimit, kryetari i KQV-së njofton komisaratin e policisë dhe KZQV-në duke i kërkuar të dërgojë në KQV punonjës të policisë që do të shoqërojnë kutitë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore.

2. Punonjësi i policisë paraqitet në kohën e caktuar nga KQV-ja dhe pret në hyrje të saj, derisa të dalin anëtarët dhe sekretari, së bashku me kutitë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore.

3. Shoqërimi i kutive të votimit dhe i kutisë së materialeve zgjedhore nga KQV-ja në vendin e numërimit të votave bëhet me automjet në të cilin ndodhen anëtarët e KQV-së, sekretari i KQV-së dhe një punonjës i Policisë së Shtetit.

4. Gjatë shoqërimit, kutia dhe materialet e tjera zgjedhore, administrohen vetëm prej kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të KQV-së. Punonjësi i forcave të policisë nuk ka të drejtë, në asnjë rast, që të posedojë apo të ketë kontakt me materialet e mësipërme.

5. Punonjësi i policisë, i ngarkuar me detyrën e shoqërimit të kutive të votimit dhe kutisë së materialeve zgjedhore nga KQV-ja në KZQV, garanton shoqërimin dhe mosprekjen e kutive të votimit nga të tretët.

6. Pas procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore, punonjësi i policisë firmos procesverbalin e marrjes në dorëzim, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja, merr një kopje të procesverbalit dhe largohet menjëherë nga ndërtesa e KZQV-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendime të KZQV-së

Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE PËR QEVERISJEN VENDORE
Bashkia/Komuna _____

MODEL – 34 V

Komisioni i Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore të Bashkisë/Komunës _____, Qarku _____, sot në orën _____, meqenëse në ambjentin e VNV-së ndodhen persona të paautorizuar dhe/ose rrezikohet rendi, bazuar në nenin 109/8, pika 2, të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.4, datë 28.09.2006 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore",

VENDOSI:

1. Të njoftojë sot në datën _____.200_ ora _____ forcat e Policisë së Shtetit për nxjerrjen e personave të paautorizuar dhe/ose rivendosjen e rendit në Vendin e Numërimit të Votave.
2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë KQZ-së.

Komisioni i Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore. _____

	Pro/kundër	Firma
1. _____ Kryetar	_____	_____
2. _____ Zv/kryetar	_____	_____
3. _____ Anëtar	_____	_____
4. _____ Anëtar	_____	_____
5. _____ Anëtar	_____	_____
6. _____ Anëtar	_____	_____
7. _____ Anëtar	_____	_____

[illegible]

E-mail
infosec@cec.org.ai



4165

MODEL I DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT TË
CILËT JANË NGARKUAR ME DEDTYRA ZGJEDHORE



DOKUMENT IDENTIFIKIMI

Grada Emer Mbiemer

Nr _____

Punonjes i Policise se Shtetit caktuar me sherbim ne

KZQV/KQV nr: _____

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES
VENDORE 200X



Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
5. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006(Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDERTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000- 2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 4.10.2006
Doli nga shtypi më 6.10.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë